



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 16, pika 16.1, shkronja **b** dhe nenit 32, pika 32.1, shkronja **e** të Statutit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 110-455, të dt. 31. 03.02008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 9.7.2009, merr

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR FILLIMIN E HARTIMIT
TË PLANIT RREGULLUES "QYTETI I VJETËR" NË PRISHTINË
01Nr. 35-591, dt. 27.12.2006

Neni 1

Neni 3 i Vendimit 01 nr. 35-591, të dt. 27.12.2006 ndryshohet si më poshtë:

"Me Planin rregullues, nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet hapësira e emërtuar Qyteti i Vjetër, e cila në anën jugore përkufizohet me rrugën "Zenel Salihu", në anën lindore me rr. "Afrim Loxha", rr."Xheladin Kurbaliu", pastaj me rr. "Haxhi Zeka", rr. "Llapi" deri te udhëkryqi me rr."Bajram Bahtiri", gjegjësisht me pikëtakimin me hekurudhën, duke vazhduar paralel me hekurudhën deri te udhëkryqi me rr. "Ilir Konushevci", duke u përmyllur me rr." Zenel Salihu", e cila përfshinë një sipërfaqe prej 42 ha.

Neni 2

Neni 7 i Vendimit ndryshohet si më poshtë:

"Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit".

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. Nr. 35-1340, më 9.7.2009

KRYETAR I KOMUNËS
Prof. dr. Isa Mustafa